

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1457 prot.

Tiranë, më 07.11.2019

URDHËR

Nr. 76, datë 07.11.2019

MBI

**“ FILLIMIN E PRANIMEVE TE APLIKIMEVE, NGA ANA E FAKULTETEVE TË
UART, PER STUDENTËT TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM OSE
REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK
2019-2020, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (indryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë,

URDHËROJ:

1. Fillimin e pranimeve të aplikimeve, nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2019-2020.
2. Personat përgjegjës që do të merren me administrimin e procesit në çdo Fakultet, janë si më poshtë:
 - Nermin Zebi (Fakulteti i Muzikës)
 - Arta Dashi (Fakulteti i Arteve të Bukura)
 - Enela Mastori (Fakulteti i Artit Skenik)
3. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në



- 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, (formulari bashkngjitur), publikuar Web-in e UART.
4. Studentët duhet të dorëzojnë aplikimet/formularin, pranë Fakultetit të tyre në personat e sipërcituar.
 5. Afati i dorëzimit të aplikimeve nga ana e studentëve është deri në datën 06 Dhjetor 2019.
 6. Personat përgjegjës i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga studentët, i përgatit informacionin Administratores së Universitetit të Arteve (UART), për miratim në Bordin e Administrimit dhe e dorëzon të gjithë dokumentacionin pranë Zyrës së Protokollit në Rektorat.
 7. Në çdo rast, kur një student aplikant paraqet dokumentacion/formularin, për përjashtimin/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2019 - 2020, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bije mbi studentin i cili do të penalizohet.
 8. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve dhe të afishohet në ambientet e Fakulteteve të UART.
 9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, zyra e Protokollit në UART, personat përgjegjës në çdo Fakultet dhe sekretaritë e Fakulteteve për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTOR

Prof. Kastriot Caushi

